



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 88

Tiranë – E enjte, 20 qershor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 29/2019, datë 23.5.2019	Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji..... 6343
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 31.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë auditimin e llogarive”..... 6347
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 31.5.2019	Mbi miratimin e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe Energia Gas and Power sh.p.k. 6349
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 78, datë 31.5.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2019..... 6350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 31.5.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011 për licencimin e shoqërisë “Dosku–Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 6351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 80, datë 31.5.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Energy 24” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 6353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 81, datë 31.5.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “S G D Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas” me fuqi të instaluar 1125 <i>kw</i> 6354
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 82, datë 31.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa”, me kapacitet të instaluar 1980 <i>kw</i> 6355
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 83, datë 31.5.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me kapacitet të instaluar 1.820 <i>mw</i> 6357

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 85, datë 31.5.2019	Mbi miratimin e “niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”	6359
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 86, datë 31.5.2019	Mbi miratimin e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “Renrgy Trading Group” sh.p.k.	6361
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 87, datë 31.5.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Englatina Xhoxhaj” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Lugano”, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.....	6362
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 88, datë 31.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve”	6364
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 89, datë 31.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror	6365
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 90, datë 31.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.....	6366
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 91, datë 31.5.2019	Mbi një ndryshim në “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.....	6368
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të vdekur të shtetasit Muhamed Demaj.	6369
	Ndreqje gabimi në ligjin nr. 27/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 ‘Për kujdesin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë’”, i ndryshuar.....	6369
	Korrigjim gabimi në vendimin nr. 265, datë 20.12.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë “BE-IS Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1”, me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali “Kalivar 2”, me fuqi të instaluar 1526 kw; hidrocentrali “Kalivar 3”, me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali “Kalivar 4”, me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw”	6369



LIGJ
Nr. 29/2019

**PËR TRAJTIMIN FINANCIAR,
SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE QË
KANË PUNUAR NË MINIERA NË
NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË
INDUSTRIË SË NAFTËS E TË GAZIT
DHE TË PUNONJËSVE QË KANË
PUNUARNË METALURGJI**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar i punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2
Përfituesit

Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat në profesione e punë, në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji, që u njihet vjetërsia në punë dhe periudha e sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 3, të këtij ligji, e që njëkohësisht plotësojnë edhe kushtet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, si më poshtë:

a) pensionistët, të cilët kanë përfutur pension sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensionistët, të cilët kanë përfutur pension sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”;

c) punonjësit, të cilët kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë;

ç) punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjellës dhe gazsjellës;

d) punonjësit që kanë punuar në metalurgji, në profesione, punë dhe ndërmarrje, sipas përcaktimeve në krerët III, VIII e XII, të pasqyrës nr. 1, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar.

Neni 3

Vjetërsia në punë dhe periudhat e sigurimit

1. Për efekt të zbatimit të këtij ligji, vjetërsia e përgjithshme në punë dhe periudhat e sigurimit vlerësohen e njihen sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të akteve ligjore në zbatim të tij.

2. Për efekt të përfitimeve nga ky ligj, vjetërsia në punë dhe periudhat e sigurimit në profesione e punë në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji do të njihen si më poshtë:

a) periudhat e punës të kryera në miniera në nëntokë, sipas dispozitave të krerëve I, XIII e XIV, të pasqyrës nr. 1 të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar;

b) periudhat e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit, në profesione dhe punë të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar;

c) periudhat e punës të kryera në industrinë e naftës e të gazit nga personeli inxhiniero-teknik,



që ka punuar drejtpërdrejt në prodhim, në sektorë apo brigada, si shpim-kërkim, shpim-shfrytëzim, prodhim, sizmikë, gjeofizikë kantieriale, përpunim dhe transport me naftësjiellës dhe gazsjiellës;

ç) periudhat e punës të kryera në metalurgji, në profesione, punë e ndërmarrje, sipas përcaktimeve në kërret III, VIII e XII, të pasqyrës nr. 1, të vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar.

3. Për efekt përfitimi, sipas këtij ligji, proceset e punës në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji, pas datës 30.9.1993, do të njihen, nëse janë kryer dhe dokumentuar sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror, si dhe në subjekte private.

4. Emërtimet e profesioneve dhe punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihen periudha në profesion, sipas nenit 3, vetëm kur është paguar kontributi sipas nenit 8 të këtij ligji.

6. Periudhat e sigurimit të pambuluara me kontribute, të paguara në fondin e sigurimeve shoqërore, nuk njihen të vlefshme për qëllime të këtij ligji.

Neni 4

Llojet e përfitimit

Personave të përcaktuar në nenin 2, të këtij ligji, u sigurohen përfitime suplementare, mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si më poshtë:

- a) pension për shkak të profesionit (llojit të punës);
- b) shtesë mbi pensionin e pleqërisë;
- c) shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

Neni 5

Kushtet dhe masa e pensionit për shkak të profesionit

Personat e përcaktuar në nenin 2, të cilët kanë periudha sigurimi, sipas përcaktimeve në nenin 3, të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimeve të pensionit për shkak të profesionit apo të shtesës mbi pension kur plotësojnë kushtet, si më poshtë:

1. Periudha e sigurimit dhe vjetërsia e punës në profesion:

a) për ish-punonjësit, të cilët kanë kryer procese pune në miniera në nëntokë, trajtimi me përfitime përpara moshës dhe kushteve të përcaktuara në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të vazhdojë të bëhet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) për ish-punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 1, “Punë, që hyjnë në kategorinë e parë”, kërret IV, pikat 2 e 3, dhe XI, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet:

- i) moshë: për burrat 55 vjeç; për gratë 50 vjeç;
- ii) periudha e përgjithshme e sigurimit: për burrat 30 vjet; për gratë 25 vjet;
- iii) vjetërsia në punë të kategorisë së parë: për burrat 15 vjet; për gratë 12,5 vjet;

c) për ish-punonjësit, të cilët kanë punuar në industrinë e naftës e të gazit, në profesione e punë të përcaktuara në pasqyrën nr. 2, “Punë, që hyjnë në kategorinë e dytë”, kreu V, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, dhe personeli inxhiniero-teknik, që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës, sipas listës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, përcaktohet:

- i) moshë: për burrat 60 vjeç; për gratë 55 vjeç;
- ii) periudha e sigurimit: për burrat 30 vjet; për gratë 25 vjet;



iii) vjetërsia në punë të kategorisë së dytë: për burrat 20 vjet; për gratë 15 vjet.

Kur nuk plotësohen kushtet, sipas shkronjës “b”, të kësaj pike, periudha e punës, sipas shkronjës “b”, i shtohet periudhës së punës, sipas përcaktimeve në shkronjën “c”, të kësaj pike. Në këtë rast, kushtet e përfitimit janë ato sipas shkronjës “c” të kësaj pike;

ç) për ish-punonjësit, të cilët kanë punuar në metalurgji në profesione, punë dhe ndërmarrje, sipas përcaktimeve në krerët III, VIII e XII, të pasqyrës nr. 1, të vendimit nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori për efekt pensioni”, përcaktohet:

i) moshë: për burrat 60 vjeç; për gratë 55 vjeç,

ii) periudha e sigurimit: për burrat 30 vjet; për gratë 25 vjet;

iii) vjetërsia në punë të kategorisë së parë: për burrat 20 vjet; për gratë 15 vjet.

2. Masa e përfitimit:

Masa e përfitimit mujor për të gjithë personat që plotësojnë kushtet, sipas pikës 1, të këtij neni, llogaritet sipas përcaktimeve në dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 6

Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë dhe të shtesës mbi pensionin e invaliditetit

1. Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë:

a) ish-punonjësit, sipas përcaktimeve në këtë ligj, të cilët kanë përfituar pension pleqërie ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension pleqërie, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë shtesë pensioni për çdo vit periudhe sigurimi në profesion, sipas përcaktimeve në nenin 3, si më poshtë:

i) punonjësit e nëntokës, 1 % të masës së pensionit të pleqërisë;

ii) punonjësit e industrinë së naftës e të gazit dhe punonjësit e metalurgjisë, 0,6 % të masës së pensionit të pleqërisë;

b) shtesën mbi pension, sipas shkronjës “a”, e përfitojnë të gjithë personat që kanë jo më pak se

6 vite në profesionet dhe punët e përcaktuara në këtë ligj;

c) shtesën mbi pension, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, e përfitojnë edhe personat që marrin pension sipas ligjit nr. 150/2014 “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, kur data e lindjes së të drejtës për pension është deri më 31.12.2014.

2. Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e invaliditetit:

a) përfituesit, sipas përcaktimeve në këtë ligj, të cilët kanë përfituar ose do të plotësojnë kushtet për të përfituar pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kanë të drejtën e përfitimit të shtesës mbi pension në masën 1 % për çdo vit vjetërsie pune në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji, sipas përcaktimeve në nenin 3 të këtij ligji;

b) për personat që përfitojnë pension invaliditeti nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, të cilët kanë vjetërsi në profesion më pak se periudha e përcaktuar në nenin 5, të këtij ligji, për efekt të shtesës mbi pension, vjetërsia në profesion, llogaritet respektivisht, për ish-minatorët 12,5 vjet, për naftëtarët dhe metalurgët 20 vjet.

Neni 7

E drejta për përfitim

1. E drejta për të përfituar pensionin dhe shtesën mbi pension, sipas këtij ligji, nuk parashkruhet.

2. Personi, i cili kërkon të përfitojë pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, e përfiton atë:

a) nga data e lindjes së të drejtës për përfitim, kur kërkesa paraqitet brenda një viti nga data e lindjes së kësaj të drejte;

b) nga data e paraqitjes së kërkesës, kur ajo paraqitet pas një viti pas lindjes së të drejtës për përfitimin e pensionit.

3. Personi, i cili ka përfituar pension, sipas përcaktimeve të këtij ligji, nuk ka të drejtë përfitimi të kësteve mujore të pensionit të pleqërisë për periudhën/at gjatë të cilave ushtron veprimtari ekonomike si i punësuar, i vetëpunësuar apo punëdhënës. Pagesat e përfitimeve ndalohen për çdo kohë që përfituesi është punësuar ose ka qenë



ekonomikisht aktiv, me përjashtim kur vetëpunësohet në bujqësi.

4. Përfitimet e caktuara, por të patërhequra, paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet. Përfitimet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet.

5. E drejta e organit kompetent për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti ushtrohet jo më vonë se 3 vjet, nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se 6 muaj, nga data e konstatimit. Masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit.

6. Personi, i cili ka përfituar pension e kompensime në mënyrë dhe me mjete në kundërshtim me ligjin dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të pensionit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë, në masën e katërfishit të dëmit të shkaktuar, pavarësisht nga dënimi i parashikuar në dispozitën përkatëse të Kodit Penal.

Neni 8 Financimi

Përfitimet nga ky ligj financohen nga kontributet dhe nga buxheti i shtetit.

1. Llojet e kontributeve:

Personat e punësuar në industrinë minerare, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji, dhe punëdhënësit e tyre janë të detyruar të paguajnë kontribut për:

- a) pension për shkak të profesionit;
- b) përfitimet shtesë mbi pensionin e pleqërisë.

Shuma e kontributit varet nga paga totale (bruto) e punëmarrësit. Kontributi nuk mund të paguhet nën pagën minimale dhe mbi pagën maksimale mujore për efekt të pagimit të kontributeve të sigurimeve shoqërore.

2. Masa e kontributit:

a) kontributi, që paguhet për mbulimin e përfitimeve të pensioneve për shkak të profesionit, përcaktohet në masën 5 % të pagës bruto dhe ndahet në 3 % nga punëdhënësi dhe 2 % nga punëmarrësi;

b) kontributi që paguhet për mbulimin e përfitimeve shtesë mbi pensionin e pleqërisë përcaktohet në masën 5 % të pagës bruto dhe ndahet në 2,5 % nga punëdhënësi dhe 2,5 % nga punëmarrësi.

Faqe| 6346

3. Kontributet, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, paguhen në fondin publik për të punësuarit mbi moshën 48 vjeç. Për të punësuarit nën moshën 48 vjeç, kontributet do të paguhen në skemën e pensioneve profesionale, krijuar sipas nenit 5/2, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Kontributet për të punësuarit mbi moshën 48 vjeç, në masën sipas përcaktimeve në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 2, të këtij neni, mbledhen dhe derdhen në fondin e sigurimeve shoqërore, sipas procedurave për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të përcaktuara në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

5. Diferenca ndërmjet efektit financiar të dy llojeve të përfitimeve, sipas këtij ligji, me kontributet shtesë, do të përballohet nga fondet e buxhetit të shtetit. Shuma vjetore e transfertës nga buxheti i shtetit dhe procedurat e financimit të fondit të sigurimeve shoqërore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9 Përjashtimi nga tatimet

Përfitimet nga ky ligj nuk tatohen.

Neni 10 Indeksi

Përfitimet, sipas këtij ligji, indeksohen çdo vit, sa herë indeksohen edhe pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Indeksi dhe koha e zbatimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11 Të drejtat e njohura

1. Dispozitat e ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, për personat në moshën mbi 48 vjeç, do të vazhdojnë të zbatohen edhe pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.



2. Në ligjin nr. 8/2017, “Për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit”, pika 1, e nenit 2; nenet 9, 10, 11 e 12; pika 1, e nenit 13, dhe nenet 14 e 15 shfuqizohen.

Neni 12

Llogaritja e pensionit

Llogaritja, caktimi, administrimi dhe pagimi i pensioneve që rrjedhin nga ky ligj bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, sipas procedurave në fuqi për pensionet, në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 13

Kërkesa për përfitim

Përfitimi, sipas përcaktimeve në këtë ligj, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë pranë agjencisë së sigurimeve shoqërore të vendbanimit të tij ose pranë sporteleve të shërbimit në ato bashki ku ndodhet vendbanimi i përhershëm i personit, së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe rregulloreve të ISSH-së.

Neni 14

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 2 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 3, të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 5, të pikës 5, të nenit 8, të nenit 10 dhe nenit 13 të këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 23.5.2019

VENDIM

Nr. 76, datë 31.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI SISTEMIN E NJËSUAR TË LLOGARIVE PËR SHOQËRITË E RREGULLUARA NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR, PËRFSHIRË AUDITIMIN E LLOGARIVE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 19, pika 1, germa “P”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, për miratimin e “Rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive në sektorin e gazit natyror”, përfshirë auditimin e llogarive,

konstatoi se:

- ERE ka autoritetin për miratimin e rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive në sektorin e gazit natyror mbështetur në nenin 16, pika 14, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, duke mbajtur në konsideratë parimet e shprehura në:

- nenin 32, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ku parashikohet se, ERE miraton metodologjinë dhe përcakton tarifat për aksesin në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifat e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifat për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifat e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik.

- nenin 31 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ku parashikohet se ERE, në kryerjen e funksioneve të saj, ka të drejtën e aksesit në të dhënat dhe dokumentacionin financiar të shoqërive të gazit natyror, sipas përcaktimeve të nenit 30 të këtij ligji.



- nenin 30, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, ku përshkruhet metoda e mbajtjes së llogarive dhe përgatitjes së pasqyrave financiare të subjekteve të rregulluara.

- ERE në konsulencë me USAID, ka përgatitur draft-Rregulloren mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë auditimin e llogarive.

- Rregullorja e propozuar, paraqitet e strukturuar në 17 nene dhe një shtojcë e cila përmban listën e llogarive të ndara sipas aktiviteteve të licencuara dhe do të shërbejë si udhëzues i mbajtjes së llogarive nga të licencuarit në sektorin e gazit natyror me qëllim ushtrimin nga ERE të detyrës së kontrollit, monitorimit dhe auditimit të llogarive të shoqërive që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e gazit natyror.

- Shtojca 1 e rregullores, është hartuar duke bërë një ndarje të llogarive sipas veprimtarive të licencuara, dhe duke i përshtatur këto llogari me klasat e zërave të “Pasqyrave të pozicionit financiar” që aktualisht përdoren në listën e njësuar të llogarive për sektorin e energjisë elektrike.

Kjo rregullore synon të sigurojë:

- Një sistem të qëndrueshëm dhe të njëjtë të mbajtjes së llogarive për vlerësimin e investimeve dhe metodologjitë e miratimit të tarifave që zbatohen nga ERE,

- Uniformitetin në raportimin mbi kostot, të ardhurat dhe investimet nga shoqëritë e rregulluara

- Thjeshtëzimin e përpunimit dhe analizimit të elementëve të kostos dhe të ardhurave që përdoren për përcaktimin e kërkesës për të ardhurat e kërkuara të arsyeshme të shoqërive të rregulluara gjatë procesit të aplikimit të tarifave dhe vlerësimit të investimeve.

Kjo rregullore do të shërbejë si bazë për kontrollet, monitorimet dhe auditimet e llogarive, të shoqërive që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e gazit natyror, nga ana e ERE-s.

- Rregullorja ofron kuadrin e nevojshëm, për:

- llogaritjen e kostove dhe të ardhurave operative,

- amortizimin, dhe

- normën e kthimit mbi bazën e rregulluar të aseteve.

- Rregullorja mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në Sektorin e Gazit Natyror është përgatitur bazuar në:

- praktikat më të mira rregullatore dhe kontabile,

- legjislacionin përkatës për kontabilitetin në Shqipëri, si dhe

- strukturat e llogarive në përdorim nga ERE për sektorin e energjisë elektrike.

Rregullorja e propozuar dhe shtojca 1 që përmban listën e njësuar të llogarive, është përshtatur me listën e njësuar të llogarive të sektorit të energjisë elektrike miratuar me vendimin nr. 244, datë 26.11.2018 të Bordit të ERE-s, dhe do të konsultohet me kompanitë e rregulluara dhe grupet e interesit, për një sistem sa më identifikues në sektorin e gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

VENDOSI :

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores mbi sistemin e njësuar të llogarive për shoqëritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë auditimin e llogarive”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 77, datë 31.5.2019

**MBI MIRATIMIN E “MARRËVESHJES
PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE” NËN SHKRUAR MIDIS
OSHEE SHA DHE ENERGIA GAS AND
POWER SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, nenit 20, pika 1, të marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “Energia gas and power” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 10004/2 prot., datë 7.5.2019, protokolluar me tonën me nr. 333 prot., datë 9.5.2019, ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike me nr. 10004 prot., datë 6.5.2019 të nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “Energia gas and power” sh.p.k., me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshje në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 28.12.2015, ka licencuar shoqërinë “Le Trading Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar dhe subjekti është mbajtës i licencës nr. 322, seria F15.

- Në vijim me vendimin nr. 165, datë 19.7.2018, Bordi i ERE-s ka vendosur, të miratojë kërkesën e shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k., për modifikimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike nr. 322, seria F15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014 ka licencuar shoqërinë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, për një afat 30-vjeçar, i ndryshuar me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018.

- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s sa më sipër cituar nr. 24, datë 15.2.2017 “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.4.2019 është parashikuar në nenin 20, pika 1 të saj se, “Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE dhe pikën 20.2 se, Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.

- Marrëveshja e nënshkruar nga palët është hartuar në përputhje me aktin e miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- Vendimi nr.58, datë 15.4.2019, ka vendosur “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit dhe ka miratuar ndryshime në dispozitat e marrëveshjes tip të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për “Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr. 10004 prot., datë 6.5.2019 nënshkruar midis shoqërisë “OSHEE” sh.a. dhe shoqërisë “Energia gas and power” sh.p.k”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 78, datë 31.5.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN MAJ 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 “Mbi rishikimin

e Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin maj 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 11200 prot., datë 21.5.2019, paraqiti në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për muaji maj 2019 dhe kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të klientët e FMF-së për muajin maj 2019 të jetë 13.62 lekë/kWh.

- Në informacioni e dërguar me anë të kësaj shkrese, për llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, është aplikuar formula për llogaritje të parashikuar në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018.

- Në tabelën përmbledhëse si më poshtë paraqiten: llogaritjet e OSHEE sh.a. dhe propozimi i ERE-s për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i mundësisë së fundit.

Çmimi për FMF për muajin Maj 2019

Maj 2019		Aplikimi OSHEE Sh.a	Propozimi i ERE
	Njësia	Çmimi	Çmimi
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parashikuar ose blerja nga prodhuesit me pasapasi	Leke/kWh	9.30
b	Kohimi për ankun i parashikuar në pasapasi për vitin (3%)	Leke/kWh	0.28
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	Leke/kWh	9.58
d	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79
e	Tarifa e përcaktimit të rrejtës të transmetimit	Leke/kWh	0.75
f	Tarifa e përcaktimit të rrejtës të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50
Çmimi i Energjisë (c+d+e+f)		Leke/kWh	13.62



- Nga informacioni i raportuar nga shoqëria OSHEE sh.a. mbi procedurat e blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, rezulton se çmimi maksimal i blerjes është 75,45 EUR /MWh për sasinë 2,976 MWh nga shoqëria ofertuese “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në fazën përfundimtare të negocimit në datën 26.4.2019 për periudhën 1.5.2019–31.5.2019 dhe fashën orare 7:00–23:00.

- Në komunikimet e mëparshme, si dhe seancën dëgjimore që ERE ka pasur me OSHEE Sh.a. ka udhëzuar që kostot administrative të cilat i përkasin Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të paraqiten të ndara nga aktivitetet e tjera të Shoqërisë. Për këtë çështje shoqëria gjate seancës dëgjimore u shpreh se gjendet në kushtet e pamundësisë së ndarjes së kostove në lidhje me FMF-në për arsye të shtyrjes për një periudhe tranzitore të procesit të ndarjes efektive sipas vendimit të bordit të ERE-s nr. 264, datë 20.12.2018. Në këto kushte është e arsyeshme të pranojmë koston për njësi prej 1,79 lekë/kWh, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) të paraqitur nga OSHEE sh.a.

- Shoqëria OSHEE sh.a. vazhdon të mospërcaktojë kostot e disbalancave për klientët e FMF-së. Për këtë çështje, në seancën dëgjimore të datës 25.4.2019 OSHEE sh.a. informoi ERE-n se ka nisur një korrespondencë me OST sh.a. për këtë kategori klientësh dhe është kërkuar prej tyre një program orar, ku të evidentohen këto diferenca midis programit dhe konsumit faktik. Gjatë kësaj periudhe, si dhe në këtë aplikim OSHEE sh.a nuk është shprehur për kostot e disbalancave ndaj konsumatorëve FMF dhe nuk ka paraqitur në ERE informacion për ecurinë e këtij procesi sikurse u angazhua nga përfaqësuesit e OSHEE sh.a. në seancën dëgjimore.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018 “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2019” është 0.75 lekë/kWh.

Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018 “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018 në lidhje

me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kWh.

- Në përfundim, nga verifikimi i informacionit dhe përlogaritjeve të paraqitura nga Shoqëria OSHEE sh.a. rezulton se, çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët në kushtet e FMF-së për muajin maj 2019 është 13.62 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 13.62 lekë/kWh për muajin maj 2019.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 79, datë 31.5.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 67, DATË 27.7.2011 PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOSKU-ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4, germa “a”, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës Administrative”, si dhe 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe



procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi “Një ndryshim në vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011 për licencimin e shoqërisë “Dosku–Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 67, datë 27.7.2011, ka vendosur si më poshtë:

1. *Licencimin e shoqërisë “Dosku–Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Gizavesh”, me kusht që: subjekti “Dosku Energy” sh.p.k. të paraqesë certifikatën e regjistrimit të pronësisë brenda 2 (dy) vjetësh nga data e dhënies së licencës.*

2. *Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.*

- ERE ka evidentuar kushtin e vendimit të licencimit nr. 67, datë 27.7.2011 dhe ka kërkuar nga ana e shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k., me shkresën nr. 691 prot., datë 1.12.2015, e duke vijuar me shkresën nr. 61 prot., datë 13.1.2016 informacion mbi statusin e plotësimit të këtij kushti.

- Shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 61/1, datë 9.2.2016, ka bërë me dije statusin e plotësimit të kushtit duke sqaruar se Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka kthyer akoma pronën e njohur me vendim gjykatë të formës së prerë me arsyetimin se ka një vakum ligjor në funksionimin e këtij komisioni.

- Në vijim të problematikës për saktësimet përkatëse mes shoqërive “Dardania” sh.p.k. dhe “Dosku Energy” sh.p.k. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 5051/1 Prot., datë 11.8.2017, ka komunikuar në ERE ngritjen e një grupi pune për shkak të rëndësisë së problematikave të evidentuara rishtazi në procedurën e ndërtimit me koncesion të formës BOO (ndërtim, shfrytëzim, pronësi), të HEC-it Gizavesh. Në këtë korrespondencë, MIE-ja thekson se, nëpërmjet grupit të punës do të shqyrtojë gjithë dokumentacionin e kësaj procedure dhe në përfundim të shqyrtimit do të bëjë me dije ERE-n lidhur me vendimin e saj.

- Në vijim të sa më sipër, ERE ka pezulluar veprimet lidhur me këtë çështje duke qëndruar në pritje të një konkluzioni të grupit të punës së MIE-s.

- Shoqëria “Dosku–Energy” sh.p.k., me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 203, datë 5.3.2019 dhe nr. 203/3, datë 3.4.2019, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë duke kërkuar një vendimarrje nga ERE.

- Certifikatën e regjistrimit të pronësisë datë 30.7.2018, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme për zonën kadastrale nr. 1715, nr. pasurie 527–N Gizavesh – Librazhd, të shoqëruara me kartelën e pasurisë dhe planvendosjen përkatëse, e cila përkon me zonën ku shtrihet projekti i HEC-it.

Sa më sipër, rezulton se shoqëria “Dosku–Energy” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 67, datë 27.7.2011, si më poshtë:

Licencimin e shoqërisë “Dosku–Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Gizavesh”, me kapacitet të instaluar 0.5 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 80, datë 31.5.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGY24” SHPK, NË AKTIVITETIN
E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, lidhur me “Licencimin e shoqërisë “Energy 24” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 19.4.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE me shkresën nr. 32/17 prot., datë 18.4.2019, ka publikuar njoftimin në median e shkruar lidhur me vendimin nr. 61, datë 19.4.2019 mbi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

-ERE në shkresën nr. 273/1 Prot., datë 2.5.2019 ka përcjellë pranë subjektit “Energy24” sh.p.k., njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

-Me shkresën me nr. 273/2 prot. hyrës, datë 14.5.2019 shoqëria “Energy 24” sh.p.k. ka përcjellë pranë ERE-s, dokumentacionin e munguar sikurse është kërkuar nga ERE.

- Në përfundim të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të

ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Energy 24” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Energy 24” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton se subjekti ka plotësuar tërësisht kërkesat, si më poshtë:

- Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” – formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar.

- Neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c” “d” dhe “e” – dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar.

- Neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d” – dokumentacioni financiar dhe fiskal, është plotësuar.

- Neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d” – dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar.

-

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy24” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 81, datë 31.5.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “S G D ENERGI” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE NGA HEC “NDËRFUSHAS” ME FUQI TË INSTALUAR 1125 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”; si dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, lidhur me licencimin e shoqërisë “S G D ENERGI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas”, me fuqi të instaluar 1125 kw,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 57, datë 15.4.2019–2.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “S G D ENERGI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 32/16 prot., datë 15.4.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar, si dhe me shkresën nr. 250/1 prot., datë 17.4.2019 ka përcjellë pranë shoqërisë “S G D ENERGI” sh.p.k. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës, si dhe mungesën e dokumentacionit të kërkuar.

- Shoqëria “S G D ENERGI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 205/2 prot., datë 2.5.2019, ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit të munguar. Në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit nr. 109, datë 29.6.2015 nuk rezultoi të këtë ndonjë

vërejtje apo ankesë nga palët e treta lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “S G D Energi” sh.p.k.

- Aplikimi i shoqërisë “S G D Energi” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë vijon:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1; germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pika 4.1.1; pika 4.1.2; pika 4.1.3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Shoqëria “S G D Energi” sh.p.k., mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncensionit”, i ndryshuar, ka aplikuar në MEI dhe është pajisur me miratimin përfundimtar nr. 2549/13 prot., datë 9.10.2017, për ndërtimin e hidrocentralit “Ndërfushas”, me kapacitet 1125 kw, që shfrytëzon ujërat në rrjedhën e mesme të përroit të Sharrës dhe Përroit të Zhavorreve, degë e përroit të Lenës, degë e lumit Mat, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër.

- Shoqëria “S G D Energy” sh.p.k ka depozituar kontratën e qirasë me nr. 142 prot., datë 15.9.2017 “Për dhënien në përdorim të sipërfaqes së zonës së zonës së mbrojtur” të lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Shoqërisë S G D Energy sh.p.k për dhënien me qira të shpërfaqjes prej 1754 m², e cila ndodhet në zonën e Mbrojtur Mali me Gropa Bizë, Martanesh, të ekonomisë pyjore/kullosore Ballenjë. Afati i kësaj kontrate do të jetë 5 vjet (nga data 15.9.2017 deri në datën



14.9.2022) me të drejtë rinovimi në zbatim të dispozitave të legjislacionit në fuqi, të drejtave dhe detyrimeve të ndërsjella, kushteve të përcaktuara në këtë kontratë ndërmjet palëve, si dhe koordinatave përkatëse të kufijve, që përcaktojnë këtë sipërfaqe.

- Shoqëria ka paraqitur lejen e Këshillit të Basenit Ujor Mat, “Për përdorim të burimit ujor”, dhënë me vendimin nr. 10, datë 27.4.2017, e vlefshme, për periudhën nga data 27.4.2017 deri 27.4.2022. Kjo leje është dhënë me qëllim ndërtimin e HEC “Ndërfushas”, duke përdorur burimin ujor të përroit të Sharrës, degë e lumit Mat.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “S G D ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ndërfushas” me fuqi 1125 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “S G D ENERGJI” sh.p.k., të depozitojë në ERE kontratën “Për dhënie në përdorim të sipërfaqes së zonës së zonës së mbrojtur”, me afat të rinovuar jo më vonë se data 14.9.2022.

3. Shoqëria “S G D ENERGJI” sh.p.k., të depozitojë në ERE “Lejen për përdorim të burimit ujor”, me afat të rinovuar, jo më vonë se data 27.4.2022.

4. Në rastin e mospërmbushjes së kushteve të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi nga ana e shoqërisë, ky vendim është objekt rishikimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM Nr. 82, datë 31.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DIEZELA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LJUSA”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, nenit 8, pika 8; nenit 10 pikat 1 dhe 3, 4 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019 mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Diezela” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Diezela” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie, nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw,

konstatoi se:

- Shoqëria “Diezela” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 316 prot., datë 26.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Diezela” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;



- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.1.3; pika 4.1.4, germa “b”, “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar.

- Shoqëria “Diezela” sh.p.k., në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar me nr. 2413/6, datë 15.12.2017 dhe në zbatim të VKM-së nr. 822 datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, ka lidhur me MIE kontratën me nr. 15 rep. dhe nr. 8 kol., datë 10.1.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw, në Përroin e Zallit të Madh, degë e përroit të Lusës, kjo e fundit degë fundore e krahut të djathtë të lumit Mat, Bashkia Mat, qarku Dibër”.

- Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e qirasë nr. 1460 prot., datë 5.6.2018, “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullosor publik shoqërisë “Diezela” sh.p.k., për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “Diezela” sh.p.k. Objekti i kësaj kontrate konsiston në dhënie me qira të fondit pyjor – kullosor për ndërtimin e HEC “Ljusa”. Nga kjo kontratë rezulton se mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral sipërfaqja e kërkuar është 2.507 ha dhe shtrihet në ngastrën: 178;173 të Ekonomisë Pyjore Derjan 1 dhe ngastrat 45 të ekonomisë pyjore Balgjaj, si dhe do të merret në përdorim sipërfaqja prej 2.507 ha në pronësi të Bashkisë Mat. Kjo kontratë mban një afat një vjeçar që fillon nga e nesërmja e datës së nënshkrimit të saj. Referuar datës së nënshkrimit, afati i kësaj kontrate përfundon në datë 5.6.2019.

- “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, në nenin 10, pika 4, parashikon se: ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licencimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.

Në pikën 4, të nenit 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, parashikohet se:

Nëse aplikuesi ka aplikuar dhe është në proces për marrjen e lejeve të tjera të nevojshme të përcaktuara në rregullore, mund të paraqesë aplikimin në ERE duke paraqitur informacion nga institucioni përkatës për fazën në të cilën ndodhet procesi i marrjes së lejeve nga institucionet e tjera.

Afati i “Kontratës së qirasë “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor kullosor publik shoqërisë “Diezela” sh.p.k. për ndërtimin e HEC “LJUSA”, të lidhur midis Bashkisë Mat dhe shoqërisë “Diezela” sh.p.k.”, përfundon në datën 5.6.2019. Si e tillë do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE brenda afatit të mbylljes së procedurave të licencimit, kontratën e rinovuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë).

- Dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC do t’i kërkohej shoqërisë të sjellë në ERE të plotësuar edhe të dhënat për tensionin e rrjetit të shpërndarjes; vitin e ndërtimit; datën e fillimit të operimit dhe jetëgjatësinë e pritshme të centralit). Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin, do t’i kërkohej shoqërisë të paraqesë në ERE të plotësimet përkatëse për të dhënat që mungojnë që kanë të bëjnë me Prodhuesin e transformatorit dhe skemën e lidhjes së përcjellësve). Neni 9, pika 4.1.4, germa “a” (dokumentacioni tekniko-ekonomik, studimi i fizibilitetit, do të saktësohet me subjektin nëse ka të hartuar një studim fizibiliteti në një dokument të veçantë), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DIEZELA” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 83, datë 31.5.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “THIRRË” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.820 mw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Sang 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 28.2.2019, ka filluar procedurën për licencimin e shoqërisë “Sang 1” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 32/7 prot., datë 1.3.2019, ka kryer njoftimin në median e shkruar si dhe me

shkresën nr. 124/2 prot., datë 6.3.2019 ka përcjellë pranë subjektit “Sang 1” sh.p.k. njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës si dhe mungesës së dokumentacionit të kërkuar.

- Shoqëria “Sang 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124/3 prot., datë 15.3.2019, ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe në vijim ERE i është drejtuar sërish me shkresën nr. 124/4 prot., datë 29.3.2019, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të mbetur pa plotësuar për këtë aplikim.

- Në vijim shoqëria “Sang 1” sh.p.k. me të sajën nr. 124/5, datë 5.4.2019 ka depozituar në ERE-s një pjesë të dokumentacionit të munguar dhe në vijim me shkresën nr. 124/6, datë 11.4.2019, ka kërkuar shtyrjen e vendimmarrjes finale të Bordit në pamundësi për t'i plotësuar dokumentet e munguara brenda afateve të përcaktuara në rregullore.

- Në mbledhjen e bordit të datës 19.4.2019, u pranua kërkesa e mësipërme dhe shoqëria u njoftua me shkresën nr. 124/7 prot., datë 2.5.2019, për afatin e shtyrë deri në datën 24.5.2019.

- Shoqëria “Sang 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124/8, datë 14.5.2019, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria “Sang 1” sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 14.12.2015, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L52414501C.

- Objekt i veprimtarisë së këtij subjekti është: *ndërtim dhe operim i HEC-eve, ku përfshihet ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike.*

- Shoqëria “Sang 1” sh.p.k., mbështetur në pikën 2, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ligj nr. 7/2017, datë 2.2.2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme”, si dhe VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë



elektrike, që nuk janë objekt koncensionit” i ndryshuar, ka aplikuar në MIE dhe ka marrë miratimin përfundimtar nr. 256/5 prot., datë 30.11.2017, për ndërtimin e HEC-it “Thirrë”, me kapacitet 1.820 mw.

- Subjekti ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë nr. 4884 prot., datë 31.10.2017, të lidhur midis Bashkisë Mirditë, me cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në cilësinë e qiramarrësit, për afatin 2-vjeçar (datë 31.10.2017–30.10.2019), për sipërfaqen prej 0.1ha dhe 9.049 km, në ekonominë pyjore kullosore Fan–Thirrë.

- Në kontratë shprehet se: *një muaj para përfundimit të afatit të mësipërm, secila palë duhet të njoftojë palën tjetër, për shtyrjen e afatit të kontratës, në të kundërt kontrata rinovohet automatikisht me të njëjtat terma dhe kushte, sipas ndryshimeve ligjore në kohën e rinovimit.*

- Subjekti ka paraqitur lejen e përdorimit të burimit ujqor nr. 97 prot., datë 8.5.2017, miratuar me vendimin nr. 16, datë 27.4.2017, të Këshillit të Basenit Ujqor Mat, Lezhë, për një periudhë vlefshmërie nga data 27.4.2017–27.4.2022, por që nuk mbulon periudhën e licencimit.

- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124/8, datë 14.5.2019, ka përcjellë Konfirmimin e vlefshmërisë së afatit të lejes për përdorimin e burimit ujqor për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë “Sang 1” sh.p.k. është 5-vjeçar, përkatësisht deri në datën 27.4.2022.

- Subjekti ka përcjellë në ERE më shkresën nr. 349 prot., datë 21.2.2017, vendimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me nr. 7 dhe nr. 103 identifikimi “Për VNM paraprak”, nga i cili rezulton se subjekti “Sang 1” sh.p.k. nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar. Kjo leje është lëshuar për të zhvilluar projektin e HEC “Thirrë”.

- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Sang 1” sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit dhe dokumentacionit për aplikim. Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe

pronësor. Neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. Plotësuar.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”. Plotësuar.

- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe pika 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. Plotësuar

- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, gjerat “a”, “b”, “c”. Plotësuar.

1.Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Sang 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë”, me kapacitet të instaluar 1820 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria “SANG 1” sh.p.k, të depozitojë në ERE, lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor nr. 97 prot., datë 8.5.2017, përpara datës 27.4.2022.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 85, datë 31.5.2019

**MBI MIRATIMIN E “NIVELEVE
KUFI/PRAGJET PËR KLASIFIKIMIN E
GJENERUESVE TË RINJ ME SISTEMIN,
NË TIPIN A, B, C DHE D, SIPAS
VENDIMIT TË ERE-s NR. 129, DATË
4.6.2018, “MBI MIRATIMIN E KODIT TË
RRJETIT MBI KËRKESAT PËR
LIDHJEN ME RRJETIN E
GJENERUESVE”**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 23, germa “b” dhe nenit 56, pika 1, germa “e”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, pika 3 dhe nenit 10 të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve” (RfG)”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018; parashikimeve të vendimit nr. 2018/03/PHLG-EnC, datë 12.1.2018, të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut në lidhje me fillimin e procedurës për miratimin e niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”,

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a. nëpërmjet shkresës me nr. 2033 prot., datë 15.3.2019, ka përcjellë në ERE propozimin për përcaktimin e niveleve kufi/pragjeve maksimale të kapacitetit për modulet gjeneruese të tipit A, B, C dhe D, në vijim të miratimit nga ERE të “Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve”(RfGj), me vendimin e Bordit nr. 129, datë 4.6.2018.

- OST sh.a. në zbatim të nenit 10 të “Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve” (RfG), paraprakisht e ka përcjellë për konsultim këtë draft, pranë palëve të interesit Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

(MIE), Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), KESH sh.a., Universitetit Politeknik të Tiranës (UPT), shoqatave AREA dhe FIAA.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 129, datë 4.6.2018, është shprehur mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 57, datë 15.4.2019, filloi procedurën për miratimin e niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”.

- ERE me shkresën nr. 32/15 prot., datë 15.4.2019, publikoi njoftimin në median e shkruar dhe me shkresën nr. 294 prot., datë 16.4.2019, njoftoi palët e interesit, MIE, OSHEE sh.a, KESH sh.a, Universiteti Politeknik i Tiranës, AREA, FIAA, DEVOLL HYDROPOWER sh.p.k, KURUM INTERNATIONAL sh.a. dhe AYEN ENERGJI AS sh.a., për këtë vendim dhe i ftoi të shprehin komentet dhe opinionet e tyre lidhur me të.

-Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve dhe objeksioneve nga palët, rezultoi se është shprehur Universiteti Politeknik i Tiranës me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 294/1, datë 6.5.2019, me anë të së cilës ka përcjellë në ERE të njëjtin material që ka dërguar edhe pranë OST sh.a. në fazën e konsultimit me palët të propozimeve për kufi/pragjet.

- MIE, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 294/2, datë 20.5.2019, ka përcjellë dakordësinë në parim për miratimin e niveleve kufi/pragjeve për klasifikimin e gjeneruesve të sistemit, të tipit A, B, C, D.

- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike në opinionin mbi draftin e paraqitur nga OST sh.a., fokusohet në evidentimin e përdoruesve aktualë të sistemit, kapacitetit të tyre të instaluar, përmbushjes së kërkesave teknike në lidhje me rregullimin tension/frekuencë, parametrat RAT (Rregullimi Automatik i Tensionit) dhe RASH (Rregullimi Automatik i Shpejtësisë), si dhe ndikimi i sigurisë operationale të sistemit elektroenergetik. Fakulteti shprehet edhe për identifikimin e opsionit më të përshtatshëm të niveleve kufi/pragjeve të klasifikimit të



gjeneruesve dhe parashtrimin e një opsioni alternativ, duke konsideruar rritjen e sigurisë statike dhe dinamike të sistemit, parashtrimin e avantazheve të opsionit alternativ sa i përket sigurisë operative, rritjes së ofertës dhe konkurrencës në tregun e shërbimeve ndihmëse dhe të balancimit, nxitjen e investimeve në burimet gjeneruese, optimizimin e kostove për balancimin nga OST sh.a dhe injektimin e shtuar nga burimet fotovoltaike.

-Komentet e përcjella nga UPT/FIE/DSEF, konvergojnë dukshëm me frymën e Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631, 14 prill 2016, “Për krijimin e një kodi rrjeti për kërkesat për lidhjen me rrjetin të gjeneruesve” (transpozuar me vendimin e ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018), si dhe me këndvështrimin e OST sh.a., në njërin nga opsionet e propozuara në dokumentin e draftuar dhe përcjellë në ERE.

- RfG përcakton katër tipa gjeneruesish, të cilët karakterizohen nga aftësi teknike të ndryshme, të cilat janë të nevojshme dhe të detyrueshme për t’u zbatuar, me qëllim mbështetjen e operatorëve të sistemit në përmbushjen e funksionit të tyre. Rregullorja e Komisionit të BE-së 2016/631, 14 prill 2016, “Për krijimin e një kodi rrjeti për kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneratorëve”, i përdor nivelet kufi/pragjet e gjeneruesve për të aplikuar kërkesat për shkëmbimin e të dhënave nga modulet e reja dhe ekzistuese të gjenerimit të energjisë. Secili nga katër tipat e gjeneruesve, parametrizohet nga niveli i tensionit të pikës së lidhjes dhe kapaciteti i instaluar i njësisë në mw. Për secilën zonë sinkrone evropiane të ENTSO-E, RfG ka përcaktuar për secilin tip nivelet kufi/pragjet e kapaciteteve në mw. Gjithashtu, duke qenë se, OST sh.a. është aktori kryesor në

këtë proces, RfG përshkruan procesin që duhet të ndjekë secili prej tyre për të përzgjedhur dhe miratuar nivelet kufi/pragjet që do të aplikohen në nivel kombëtar.

- Procesi i klasifikimit të gjeneruesve dhe përcaktimi i nivelit të kufi/pragjeve synon të balancojë nevojën e OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., për të garantuar dhe menaxhuar sisteme të sigurta dhe të fuqishme, kundrejt vendosjes së një niveli proporcional të mbështetjes së detyrueshme të gjeneruesve të lidhur me sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes.

- Opsioni i Mesëm i draftuar nga vetë OST sh.a., siguron një shpërndarje të numrit të centraleve të tipit C dhe D, të aftë për të mbështetur operimin dhe qëndrueshmërinë e sistemit respektivisht me rreth 9% dhe 4%.

- Nga analiza e draftit të përcjellë nga OST sh.a., me kufi/pragjet e tipave A, B, C dhe D, ERE vlerëson se Opsioni më i pranueshëm për t’u zbatuar teknikisht është ai i propozuar nga vetë OST sh.a., pasi pragjet janë relativisht më të ulëta në krahasim me ato të Universitetit Politeknik të Tiranës, i cili po ashtu në shkresën e tij nr. 61/1, datë 15.2.2019, në seksionin 3, ka sugjeruar si Opsion Alternativ kufi/pragjet e propozuara nga OST sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Nivelet kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin, në tipin A, B, C dhe D”, sipas vendimit të ERE-s nr. 129, datë 4.6.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”, si vijon:

Tipi A	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes <110kV dhe kapaciteti i moduleve $800W \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 1mw$
Tipi B	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes <110kV dhe kapaciteti i moduleve $1MW \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 10mw$
Tipi C	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes <110kV dhe kapaciteti i moduleve $10MW \leq P_{Max}^{Kapaciteti} < 30mw$
Tipi D	Niveli i tensionit në pikën e lidhjes $\geq 110kV$ ose kapaciteti i moduleve $P_{Max}^{Kapaciteti} \geq 30mw$



2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 86, datë 31.5.2019

**MBI MIRATIMIN E “MARRËVESHJES
PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE” NËN SHKRUAR MIDIS
OSHEE SHA DHE “ReNRGY TRADING
GROUP” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, nenit 20, pika 1, të Marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 7711/3 prot., datë 17.5.2019, protokolluar me tonën me nr.352 prot., datë 20.5.2019, ka dërguar në ERE “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të

nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k., më datë 17.5.2019, me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshje në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- ERE, me vendimin e Bordit nr.245, datë 26.11.2018, ka licencuar shoqërinë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr.96, datë 27.10.2014 ka licencuar shoqërinë “Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, për një afat 30-vjeçar, i ndryshuar me vendimin nr. 216, datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018.

- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s sa më sipër cituar nr.24, datë 15.2.2017 “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.4.2019 është parashikuar në nenin 20, pika 1 të saj përcaktohet se, “*Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE dhe pikën 20.2 se, Palët deklarojnë se nënshkrimi i kësaj Marrëveshje bëhet me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe se ky nënshkrim ka fuqi për shoqëritë të cilët ata përfaqësojnë.*”

- Në lidhje me përmbajtjen e kësaj marrëveshje, e nënshkruar dhe e dakordësuar mes palëve, konstatojmë se kanë reflektuar të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen TIP të cilën e ka miratuar dhe ndryshuar se fundmi me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019.

- Marrëveshja është hartuar në përputhje me aktin e miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 24, datë 15.2.2017, “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, i ndryshuar me vendimin nr.58, datë 15.4.2019.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për “Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr.7711/3 prot., datë 17.5.2019 nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë “ReNRGY TRADING GROUP” sh.p.k.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 87, datë 31.5.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENGLATINA XHOXHAI” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK “LUGANO”,
ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw,
NË ZONËN SHEQ MARINAS, NJËSIA
ADMINISTRATIVE TOPOJË, BASHKIA
FIER, QARKU FIER**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”; neni 5, pika 1, germa “a”; neni 10, pika 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut, lidhur me “Licencimin e shoqërisë “Englatina Xhoxhaj” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë

elektrike nga centrali fotovoltaik “Lugano”, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier,

konstatoi se:

- Shoqëria “Englatina Xhoxhaj” me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 240/2, datë 8.4.2019, ka përcjellë sqarime lidhur me aplikimin për licencë për Centralin Fotovoltaik “Lugano” me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën e Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- ERE me shkresën nr. 33/18 prot., datë 23.4.2019, publikoi njoftimin në median e shkruar, lidhur me vendimin nr. 64, datë 23.4.2019 dhe nuk ka pasur komente apo objeksione nga palët.

- Me vendimin nr. 64, datë 23.4.2019, Bordi i ERE-s vendosi: Fillimin e procedurës për licencimin e “Englatina Xhoxhaj” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik “Lugano”, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, njësia administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Englatina Xhoxhaj është mbajtës i miratimit përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018, dhe kontratës nr. 6583 rep. dhe nr. 2075 kol., datë 29.12.2018, të lidhur ndërmjet MIE dhe znj. Englatina Xhoxhaj.

- Shoqëria ka përcjellë në ERE edhe shkresën nr. 1 prot., datë 3.4.2019, me anë të së cilës ka bërë me dije për ndryshimin e statusit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ERE-n, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, dhe OSHEE sh.a. (shkresë kjo e protokolluar në ERE me nr. 240, datë 21.3.2019). Shoqëria shpjegon se nuk ka asnjë ndryshim të pronësisë së centralit fotovoltaik LUGANO, dhe aksionet e shoqërisë “Englatina Xhoxhaj” sh.p.k. janë në zotërim 100% të znj. Englatina Xhoxhaj.

- Neni 3, i ligjit nr. 9901, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” parashikon që: *Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përvaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).*

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Englatina Xhoxhaj” sh.p.k., është themeluar nga personi fizik



Englantina Xhoxhaj, mbajtëse e miratimit përfundimtar me nr. 9310/2, datë 19.12.2018, dhe kontratës nr. 6583 rep. dhe nr. 2075 kol., datë 29.12.2018, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe personit fizik “Englantina Xhoxhaj”, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaiik ‘Lugano’”, me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Topojë, qarku Fier.

- Aplikimi i kryer nga personi fizik, themelues i personit juridik, i cili ka tagrin e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaiik “Lugano”, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për centralet solare (neni 9, pika 4.4.1; pika 4.4.2 ; pika 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pika 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; pika 4.4.5, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Lejet nga institucionet e tjera (neni 9, pika 4.5, gjerat “a”, “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Shoqëria ka paraqitur në ERE, kontratën e qirasë nr. 976 rep. dhe nr. 273 kol, datë 25.5.2018, të lidhur me qiradhënësin Bashkia Fier me palën qiramarrëse Bashkimi i përkohshëm i shoqërisë ETS sh.p.k. dhe personi fizik “Englantina Xhoxhaj, për sipërfaqen 113.000 m², tokë e pafrytshme (pronë shtetërore), e ndodhur në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, e regjistruar në ZRPP Fier. Në bazë të nenit 2 të saj, kjo kontratë lidhet për një afat 20-vjeçar me të drejtë përsëritje ose me të drejtën e rinovimit apo të parablerjes (privatizimit), në kohën e përfundimit të afatit të kontratës.

- Shoqëria ka paraqitur, gjithashtu, sipas kërkesës së ERE-s, kontratën e bashkëpunimit nr. 976/1 rep. dhe nr. 275 kol., datë 24.5.2018, të lidhur midis shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., Eglantina Xhoxhaj dhe Bashkisë Fier, të njësuar me origjinalin, në lidhje me shprehjen e bashkëpunimit për ndërtimin e të dy centraleve me qëllim që projekti i ndërtimit dhe zbatimit dhe shfrytëzimi i tokës të jetë sa më i mirë dhe eficient.

Personi fizik “Englantina Xhoxhaj”, ka përcjellë në ERE shkresën e OSHEE sh.a. me nr. 12028/1, datë 29.6.2018, me anë të së cilës OSHEE sh.a., i drejtohet znj. Englantina Xhoxhaj, “Për miratim ndryshim pikë lidhje të centralit fotovoltaiik”.

- “Englantina Xhoxhaj”, për të zhvilluar projektin **“Ndërtimi i centralit fotovoltaiik ‘Lugano 2’**, ka paraqitur në ERE, VNM paraprake me nr. 1964 prot., datë 25.6.2018, nga Drejtoria e Vlerësimit Mjedisor. Nga përmbajtja e kësaj VNM-je rezulton se, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas përfundimit të procedurave paraprake të VNM-së, me vendimin nr. 28, nr. identifikimi 447 vendosi që ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet procedurës së VNM-së së thelluar. Në këtë VNM pasqyrohen të dhëna teknike: sipërfaqja e zënë me modulet: 18.500 m²; Kapaciteti i instaluar prej 2 mw; nr. i moduleve 7448 ; vendndodhja zona kadastrale: 3358; **parcela nr. 287/5** Sheq Marinas Fier. ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet. Por duke qenë se nga të dhënat për projektin e impiantit rezulton se jetëgjatësia e pritshme e një paneli është 25 vjet, kohëzgjatja e licencës për ndërtimin dhe operimin e një centrali fotovoltaiik, kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Englantina Xhoxhaj” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaiik “LUGANO” me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.



2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM
Nr. 88, datë 31.5.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË
GJITHA OST-ve PËR NJË METODOLOGJI
TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË
PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË
RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE)
2015/1222, TË DATËS 24 KORRIK 2015, QË
PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI
ALOKIMIN E KAPACITETIT DHE
MENAXHIMIN E KONGJESTIONEVE”**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 19, 23, 56 dhe 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, neneve 58, 62; 64 dhe 104 të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendim të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtar me të drejta të plota e European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E), Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 2035 prot., datë 15.3.2019, protokolluar në ERE me nr. 228 prot., datë 18.3.2019, ka përcjellë për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 korrik 2015 që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve.”

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar me ligjin 8/2018, përkatësisht nenet 7, 19, 23, 56 dhe 67, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të ERE nr. 186, datë 10.11.2017, kapitulli IV në tërësi dhe nenit 64 “Modeli i rrjetit për D-1 Dhe D” në veçanti; nenit 104 të “Modelet individuale të rrjetit, modelet e bashkuara të rrjetit dhe Analizat e sigurisë Operative”.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit.

- Dokumenti i përbërë nga 24 nene me kërkesa specifike mbi modelin individual të rrjetit, skenarët, modelin e përbashkët të rrjetit, parametrat e cilësisë së MIRR-së dhe MPRR-së, blloqet baze të modelit, procesin e bashkimit të modeleve individuale, impaktin e pritur në objektivat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, dhe merr parasysh sigurinë operationale, optimizimin në llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërzonal duke siguruar trajtim të drejtë dhe jodiskriminues të pjesëmarrësve të tregut, si dhe duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit.

- Në përputhje me vendimin e marrë nga European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E) dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjitha OST-të dhe interkonjeksionet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen, gjithashtu, që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.



Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Propozimit e të gjitha OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222, të datës 24 korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongestionëve”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 89, datë 31.5.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ALBPETROL” SHA, NË AKTIVITETIN
E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 4, pika 11, 12, 50; nenit 22, pika 2, germa “c”; nenit 75, pika 1, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “c”; nenit 5; nenit 8, nenit 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”; pika 2, germa “f”; dhe nenit 10, pika 1, të “Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2019 nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i

ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, lidhur me fillimin e procedurave për Licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 348 prot., datë 16.5.2019, shoqëria “Albpetrol” sh.a., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të aplikimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, rezulton se:

- Neni 9, pika 1, “Format dhe dokumentacioni për aplikim”:

- germa “a” “b” “c”, janë plotësuar.

- germa “d” “Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor”,

- pikat:

i. është plotësuar;

ii. është e pa plotësuar;

iii. pa plotësuar;

vi. është e pa plotësuar.

- Germa “e”. Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale,

- pikat:

i. është e pa plotësuar.

ii. është e plotësuar pjesërisht

iii. është i pa plotësuar.

iv. është e pa plotësuar.

v. është e pa plotësuar.

- Neni 9, pika 2 “dokumente specifike për llojin e licencës”

- Germa “f”, pikat:

i. është e pa plotësuar

ii. është plotësuar

iii. është plotësuar

Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transmetimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave për sektorin e gazit natyror”, t’i paraqesë në ERE, këto dokumente brenda afatit të caktuar.

- Neni 23, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, parashikon se: ERE përcakton afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili, për veprimtaritë e



transmetimit, të shpërndarjes, të depozitimit dhe të GNL-së, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet dhe për veprimtaritë e tjera nuk mund të jetë më shumë se 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje;

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e Furnizimit të Gazit Natyror, për një afat 10-vjeçar.

2. rejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 90, datë 31.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DRAFTKONTRATËS NDËRMJET KESH SHA DHE OSHEE SHA, PËR SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI UNIVERSAL ME QËLLIM MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIU DHËN KOHORE 1.1.2019–31.12.2019

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullores për

organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur me “Fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”,

konstatoi se:

- Në shkresat me nr. 2264/1 prot., dhe nr. 2264 prot., datë 13.5.2019, protokolluar me tonat nr. 340/1, datë 15.5.2019 dhe nr. 340, datë 15.5.2019, është paraqitur për miratim pranë ERE-s, “draftkontata ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 16, datë 18.2.2019 mbi “Shtyrjen e afatit të zbatimit të “Kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.1.2018–31.12.2018”, dhe “Kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, pika 1 e tij vendosi:

1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të Kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, deri në paraqitjen e draftkontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., dhe miratimin e saj nga ERE.

- Me shkresën me nr. 176/1 prot., datë 6.3.2019 dërguar shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., ERE ka bërë me dije palët se: “shtyrja e afatit të



kontratave të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 16, datë 18.2.2019 erdhi si rrjedhojë e konstatimeve mbi mungesën e dakordësisë mes palëve për nënshkrimin e kontratave të vitit 2019.

- Gjithashtu, në korrespondencën sa më sipër cituar, ERE u ka bërë me dije palëve se mungesa e kontratave të dakordesuara nuk i çliron palët (KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.) nga detyrimi për të depozituar në ERE për miratim këto kontrata në përmbushje të parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

- Në përgjigje të korrespondencës sa më sipër, u paraqit për miratim në ERE “draftkontrata ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019.

- Nga shqyrtimi i kontratës së paraqitur dhe të dakordësuar e nënshkruar mes OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a., për vitin 2019 konstatojmë se ka ndryshime nga kontrata e miratuar më 2018-n, të cilat konsistojnë në nenin 4.

Në konkluzion duke konstatuar:

- të drejtën e ERE-s për miratimin e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019” në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e “Kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar; dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit dhe funksionimit të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, i propozojmë Bordit të ERE-s:

- dakortësinë e palëve me njëra-tjetrën mbi “Kontratën ndërmjet “KESH”sha dhe “OSHEE”sha, për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së

kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”, e pasqyruar kjo në nënshkrimin e saj nga palët.

- KESH sh.a. legjitimohet si palë në rolin e prodhuesit të energjisë elektrike dhe OSHEE sh.a. në rolin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë elektrike.

- Për ndryshimet e konstatuara në kontratë që konsistojnë në neni 4, do t’u kërkohej informacion palëve lidhur me arsyet e ndryshimeve dhe përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrir Ahmeti

**VENDIM****Nr. 91, datë 31.5.2019**

**MBI NJË NDRYSHIM NË
“MARRËVESHJEN PËR SIGURIMIN E
SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
OSHEE SHA DHE FURNIZUESVE TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË
MIRATUA ME VENDIMIN E BORDIT
TË ERE-s NR. 24, DATË 15.2.2017, I
NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 58,
DATË 15.4.2019**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016; nenin 19, pika 2, të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, “Mbi ndryshimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike”, të miratua me vendimin e bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019”,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e bordit nr. 24, datë 15.2.2017 miratoi “Marrëveshjen e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe furnizuesit të energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e bordit nr. 58, datë 15.4.2019,

- Në vijim të kësaj procedure, ERE ka miratuar një sërë marrëveshjesh ndërmjet OSHEE sh.a. dhe disa furnizuesve të energjisë elektrike, të tilla si:

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sha me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji

elektrike “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., miratuar me vendimin e bordit nr. 79, datë 6.4.2018.

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sha, me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “KASTRATI ENERGY” sh.p.k., miratur me vendimin e bordit nr. 74, datë 10.5.2019,

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a., me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “GSA” sh.p.k.”, miratuar me vendimin e bordit nr. 77, datë 6.4.2018.

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a., me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “Grid Energy” sh.p.k., miratuar me vendimin e bordit nr. 111, datë 14.5.2018.

- “Marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike që ka nënshkruar OSHEE sh.a., me shoqërinë e licencuar në aktivitetin e furnizimit me energji elektrike “Albanian Energy Supplier” sh.p.k. (AES sh.p.k.), miratuar me vendimin e bordit nr. 78, datë 6.4.2018,

- Neni 20.1 i marrëveshjes tip përcakton se:

“Kjo Marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 për t'u dërguar për miratim në ERE”.

- Duke qenë se marrëveshjet me furnizuesit, si më sipër cituar, lidhen konform “marrëveshjes TIP” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.24, datë 15.2.2017, ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, është i panevojshëm miratimi rast pas rasti i të gjitha marrëveshjeve të lidhura mes OSHEE sh.a., dhe furnizuesve të licencuar në aktivitetin e furnizimit.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për ndryshimin e nenit 20, pika 1 të “Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a., dhe furnizuesit të energjisë



elektrike”, miratuar me vendimin e nr. 24, datë 15.2.2017, i ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, si më poshtë:

- 20.1 “*Kjo Marrëveshje bartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën Palë dhe 1 dërgohet në ERE për dijeni*”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM **(i shkurtuar)**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3035, datë 26.4.2019, vendosi shpalljen të vdekur më datë 22.8.1977, të shtetasit Muhamed Demaj, i datëlindjes 16.12.1950, si dhe caktimin në cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij kërkuesin Kliton Lopci.

NDREQJE GABIMI

Në ligjin nr. 27/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 30.5.2019 bëhet korrigjimi material si më poshtë:

Neni 23 “Hyrja në fuqi” referenca, “neni 15, pika 5” të bëhet **“neni 15, pika 4”**.

KORRIGJIM GABIMI

Në vendimin nr. 265, datë 20.12.2018 “Mbi licencimin e shoqërisë “BE-IS Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Kalivar 1”, me fuqi të instaluar 1475 kw; hidrocentrali “Kalivar 2”, me fuqi të instaluar 1526 kw; hidrocentrali “Kalivar 3”, me fuqi të instaluar 3321 kw; dhe hidrocentrali “Kalivar 4”, me fuqi të instaluar 275 kw, me fuqi totale të instaluar 5597 kw”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 1.2.2019, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Kudo në vendim, kapaciteti i instaluar **1526 kw** bëhet **526 kw**.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë